



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE  
DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR GRAMSH

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

**Shtojca 11**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data]

**Drejtuar:** V.A.L.E. RECYCLING- LEZHE ,Fushe Kuqe GUREZ Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit

**Procedura e prokurimit/lotit:** - ‘‘Evadimi Mbetjeve Spitalore’’- Procedure e Hapur e Thjeshtuar - Marrëveshje Kuadër me nje operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 (muaj)

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** Përshkrimi i shkurtër i kontratës: - REF-07057-10-04-2021- ‘‘Evadimi Mbetjeve Spitalore’’- Procedure e Hapur e Thjeshtuar - Marrëveshje Kuadër me nje operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 (muaj)

Publikimet e mëparshme **JO** (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. V.A.L.E. RECYCLING**

L28029301Q

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera 2,560,000 (dy million e peseqind e gjashtedhete mije) lek pa tvsh

(me numra dhe fjalë)

**2. ECO RICIKLIM**

L61814009B

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera 4,800,000 (kater milion e teteqind mije) lek pa tvsh

(me numra dhe fjalë)

**3. MEDI-TEL**

J71519004W

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera 2,300,000 (dy milion e treqind mije) lek pa tvsh

(me numra dhe fjalë)

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. 1 <b>ECO RICIKLIM</b>	L61814009B
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
1. 2 <b>MEDI-TEL</b>	J71519004W
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. **ECO RICIKLIM** – *është skualifikuar pasi ka paraqitur oferte ekonomike mbi fondin limit dhe per mungese dokumentacioni sipas DST-se se publikuar (asnje dokument te ngarkuar ne SPE).*
2. **MEDI-TEL** – *është skualifikuar per mungese dokumentacioni sipas DST-se se publikuar.*

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

**Se Pari :** Nuk ploteson piken nr 2.4 **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”,
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambientit”
- BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

*Çertifikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga nje organ I vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizmi kombetar I akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga RSH.*

**Ne dokumentacionin e paraqitur ne plotesim te ketij kriteri, Certifikatat ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”, dhe ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambientit” nuk jane te shoqeruara me konfirmimin e vlefshmerise vjetore sipas sic sanksionohet ne vete formatin e certifikatave ISO qe ka paraqitur ne SPE.**

**Se dyti:** Nuk ploteson piken nr **2.4.2 ku percaktohet:** Duke qene se, ne baze te VKM 798, Date 29.09.2010, AK si krijues i mbetjeve është përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë, kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me landfill ose subjekt të licensuar (shqiptar apo të huaj) për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e autoklavimit dhe incenerimit, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Landfilli ose subjekti i licensuar duhet të jetë i autorizuar në lejet mjedisore përkatëse, për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore sipas rastit, për këtë duhet të paraqesë dhe Lejen dhe licencën përkatëse të landfillit ose të subjektit.

**Gjate verifikimit ne SPE rezulton se OE Ekonomik “Medi -Tel” nuk ka paraqitur lejen mjedisore te Landfillit Integrated Technology BV SPV per depozitimin e produktit final.**

**Se treti :** Nuk ploteson piken **1, shkronja b** *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës*

Komisioni i Vleresimit të Ofertave, bazuar në nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”,* në nenin 26 të VKM-se 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës , personi/personat

ne cilesine e organit administrativ, drejtorit ose mbikqyresit, si aksionar ose si ortak , ka ose fuqi perfaqesuese ose vendimmarrese ose kontrolluese brenda orperatorit ekonomik .

**Nga verifikimi ne SPE i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, te paraqitur nga OE, rezulton se ne rolin e personi/personat ne cilesine e organit administrativ, drejtorit ose mbikqyresit, si aksionar ose si ortak , ka ose fuqi perfaqesuese ose vendimmarrese ose kontrolluese brenda orperatorit ekonomik, si administrator te shoqerise eshte vetdeklaruar nje Administrator me inicialte E.K, Referuar ekstraktit te QKB , te ngarkuar ne SPE nga ana e OE, konfirmuar edhe online ne web-in : <https://qkb.gov.al> rezulton qe jane dy administratore te shoqerise ( Inicjalet E.K dhe A.P.)**

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ **Medi- Tel** , per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese (**pra nuk ka deklaruar administratorin me inicialet A.P.**).

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “**MEDI-TEL**” **SH.P.K.**, skualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *V.A.L.E. RECYCLING- LEZHE* ,Fushe Kuqe GUREZ Fshatin Gurez,afër ish-Kanalit te Acidit se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2,560,000 (*dy million e peseqind e gjashtedhjetë mijë*) lek pa tvsh

/ totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTORI**  
**Greta LENA**